

# Punësohen 75 të rinj

Falë mbështetjes së dhënë nga USAID-i, që është ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, janë punësuar 75 të rinj. Në solemnitetin që u mbajt të martën, veç nikoqirit, USAID-it, merrnin pjesë edhe ministri i MASHT-it, Enver Hoxhaj, rektori i UP-së, Mujë Rugova, etj. Mark Vud, drejtor i KPEP-it, tha se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës. Për t'u ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës.

Më shumë informata mbi këtë projekt dha Lindita Baleta, specialiste për komunikim me programin për ndërmarrje private në Kosovë. Programi është një nismë katërveçare e filluar në tetor 2008 dhe synon stimulimin e aftësisë konkurruese të sektorit privat në ekonominë e Kosovës. Ajo tha se trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat. Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service - Austria (WUS - Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent. "Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar", ka thënë Baleta. Programi i praktikës për industrinë e përpunimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPKD), i angazhoi 16 studentë nga Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe nga Shkolla Profesionale dhe të Zdrukthëtarisë dhe Qendra për Aftësim Profesional, të gjithë klientë të KPEP-it. Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për shkak se 16 studentëve u është ofruar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. Deri më sot, 14 prej tyre i kanë pranuar ofertat për punë. Blerim Hyseni nga Bajçina e Podujevës tha se falë trajnimit 4 mujor të USAID-it ai është punësuar në një firmë private të drurit. Organizatori në fund 174 përfituesve u shpërndau diplomat si dëshmi e projektit të përfunduar. **S.Blaku**

03/11/2010 "Kosova sot"